

INTERVISTË ME AVDI DINAJ

Mitrovicë | Data: 28 tetor, 2021

Kohëzgjatja: 61 minuta

Të pranishëm:

1. Avdi Dinaj (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotëri Dinaj, nëse mundeni me u prezantu? Vitin, datën e lindjes, vendin, diçka për familjen e juaj, prejardhjen?

Avdi Dinaj: Po, unë quhet Avdi Dinaj, i lindur me 15. 4. 1952, në fshatin Raushiq, komuna e Pejës. Shkollën fillore e kom të kryme në fshatin Raushiq, gjimnazin në Pejë, Fakultetin Juridik në Prishtinë. Rrjedhi nga një familje fshatare, baba edhe nona ime kanë qenë të pashkollum, kanë pasë nontë fëmi. Po kanë qenë adhurus të flaktë të arsimit, njëashtu që me punë bujqësore kanë arritë me i shkollu gjashtë prej tyne, të cilët kanë kry fakultet.

Unë pas studimeve kam tentu që të punësohem në Gjykatën e Pejës. Mirëpo, tani, i ndjeri Riza Loci ka qenë kryetar i Gjykatës së Qarkut në Pejë, tu na njoft familjarisht, më ka thonë, thotë, “Tu e ditë që vëllau yt ka qenë i burgosur politik”, i cili ka qenë i denum me katër vite burg, të cilat i ka majt në Goli Otok për çështje politike thotë, “edhe nëse fillon punën këtu, nuk do të lejojnë me vazhdu. Gjasat janë shumë të vogla, andaj për me humb gjurmë shko dika tjetër”. Edhe pse ka pasë nevojë për jurista në atë kohë në Pejë.

Pastaj rastësisht kam kthy në Mitrovicë, pa e njohur askend. Fati deshti në fillim me 1 dhjetor, të vitit 1976, pas nja gjashtë-shtatë mujve pa punë kom fillu si praktikant në Gjykatën Komunale në Mitrovicë. Por atëherë ka qenë, puna e juristëve u përcillke nga ana e eprorëve të organeve në Mitrovicë. Edhe pas tre mujsh ish-kryetari i Gjykatës Komunale të asaj kohe më thotë, “Qite kërkesën për gjyqtar”.

Kanë qenë shumë praktikant në atë kohë, prej atyne na kanë zgjedhë tre vetëve me konkuru. Dikun 30 mars të vitit 1977, jam zgjedh gjyqtar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë. Pas një kohe jam martuar, këtu me një mitrovicase, kom punu diku rreth shtatë vite si gjyqtar në Gjykatën Komunale. Kam qenë i martuar në atë kohë i kam pasë tre fëmi. Me kërkesë më është dhënë një banesë nga Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit Komunal në Mitrovicë. Pastaj kam ngelë në Mitrovicë.

Më vonë me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës, për shkak mungesës së kuadrave, nga viti '84 apo '85 kam fillu si gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Dej në vitin '92, kur Kuvendi i Sërbisë na ka shkarku, pothujse të gjithë gjyqtarët në Kosovë. Periudhën tjetër kom punu si avokat dej në vitet 2000, në 2000 jam kthy sërish si gjyqtarë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Pastaj në 2002-tën, diku me 11 nëntor jam zgjedhë si gjyqtarë i Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, ku kom punuar deri në pensionim.

Fëmijëria ime ka qenë e vështirë sikurse... përveç pesë hektarëve tokë të cilën e kemi punu, burim tjetër të të ardhurave nuk kemi pasë. Mirëpo, vullneti i madh për shkollim, ka fillu vëllau i madh Sylë Dinaj, i cili është tani i ndjerë. Ka qenë nxanës i gjimnazit të Pejës, me korrespondencë. Njëashtu që kur arrinë në vitin tretë, katërt të gjimnazit nuk ka qenë nxanës i rregullt, me korrespondencë, bie në burg politikisht.

Anita Susuri: Në cilin vit? A e dini në cilin vit?

Avdi Dinaj: Vitin 1962. Pastaj gjykohet diku katër vite burg, të cilat i mban në Goli Otok. Meqë ka qenë vëllau i madh edhe krahu i shtëpisë, gjendja u vështirësu ekonomike edhe ma shumë. Kur ai ka qenë në burg unë kam qenë dikun në klasën e katërt të shkollës fillore. Pas kthimit nga burgu, ai e ka vazhdu shkollimin. Mirëpo, ka qenë ni fat i madh që nuk ja kanë hup të drejtën e shkollimit, se atëherë ra politikisht në burg kanë mujt me ja hup edhe drejtën e shkollimit.

Anita Susuri: E pse është burgos ai? Çfarë aktiviteti ka bo?

Avdi Dinaj: Vepimtari armiqësore si i thojshin në atë kohë. Çashtje politike, ka qenë një grup prej dikun nja 20 e diçka persona. Pastaj pas kthimit nga burgu ka vazhdu shkollimin. Ka kry shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, ndërsa unë i kom regjistru studimet në Prishtinë. Gjendja ekonomike filloi përmirësimi meqë ishte ai në marrëdhënie pune, na ndihmonte me të ardhurat e tina, plus prodhimet bujqësore. Kështu që... ka qenë një jetë e fshtirë.

Anita Susuri: Në atë kohë kur ka qenë i burgosun vëllau i juv, Goli Otoki osht' një vend me emër të keq, domethonë vështirë ka qenë. A ju kujtohet familja e juv, prindtë a kanë qenë të shqetësuar? Sigurisht kanë qenë të shqetësuar, po si e keni pa ju ato si fëmi?

Avdi Dinaj: Ajo ka qenë, ajo ka qenë si me të ra ni bombë në shpi. Hm? Ka qenë vëllau ma i madhi, ai faktikisht pas prindve ka qenë kujdestari kryesor i familjes. Mirëpo, pas përfundimit të studimeve, punësimi tina, se ai është dashtë atë kohë me u punësu, u punësu në Dragash; se në atë kohë me u punësu në afërsi të Pejës, nuk e lejonin meqë ka qenë i gjykom politikisht.

Pas nja tri-katër vite që ka punu në Brodosanë, në fshatin Brodosanë, si arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Ka qenë drejtor i shkollës fillore në Raushiq një i familjes së njohur Mulliqi edhe tu e pa që po udhëton, thotë, "Eja këtë vit se do t'ia nisish punës në Raushiq". Pastaj ka punu një periudhë në Raushiq e pastaj si arsimtar i gjuhës shqipe në Loxhë, dej në pensionim. Une pas kryerjes së studimeve, kam marrë banesë, kam qenë i martuar.

Anita Susuri: Po qysh ka qenë për juve me ardhë prej rrethit të Pejës me u vendos në Mitrovicë, qysh e ka përballu këtë familja?

Avdi Dinaj: Po në atë kohë të ardhurat kanë qenë diku mesatare. Ni pjesë, ni pjesë të ardhunave i kom nalë për shpenzime të mia, pjesën tjetër ju dërgojsha prindëve se u dashtë me i shkollu edhe vllaznit edhe motrat tjera të cilët kanë qenë në shkollim. Dy motra e kanë kry fakultetin, u dashtë me ju ndihmu deri sa janë dalë secili në punën e vet, me siguru ekzistencën e vet.

Anita Susuri: Ju kur jeni vendos në Mitrovicë me siguri e keni shitë atje vendin apo si ka ndodhë kjo?

Avdi Dinaj: Nuk e kom, nuk kemi shitë kurgjo, nuk kemi shitë kurgjo. Edhe sot pas ndarjes nga vllaznit, posedoj nja tre hekterë tokë të cilën e punojnë kusherinjtë. Mirëpo, është në pronësinë time si trashëgimi.

Anita Susuri: Po kthehem pak, si ka qenë për juve periudha e viteve të shkollës mesme?

Avdi Dinaj: Ka qenë shumë e vështirë, shumë e vështirë ka qenë. Fshati Raushiq, gjimnazi i Pejës e kanë pasë dikun ni distancë shtatë kilometra, tetë. Qarkullimi për nxanës ka qenë shumë i vështirë. Atëherë vinte autobusi dikun në tetë fillojke mësimi, nji autobus e ke pasë, nëse nuk e nxen autobusin, u dashtë në komë me mrrri. A autobusi Pejë-Deçan në atë kohë ka qenë i ngarkum {bashkon gishtat} me nxanësa. Kështu që, nuk ke mujt me pritë autobusin tjetër se je vonu për mësim.

Anita Susuri: A ju ka ndodhë najherë me ju ikë autobusi, me shku në komë?

Avdi Dinaj: Jo me më ikë, po ka ndodhë që me qenë i mbushur e mos me u ndalë fare në Raushiq. Edhe pastaj krejt ajo grupë e nxanësve në komë në Pejë. Gjimnazi edhe Normalja sidomos ka pasë shumë nxanës të asaj treve.

Anita Susuri: E qysh ka qenë jeta, për shembull sociale ose kulturore, a ka pasë vende ku keni dalë, ose për rekreacion, ose për me kalu kohë, ose aktivitete kulturore?

Avdi Dinaj: Aktivitete kulturore ke mujt vetëm si nxanës. Shembull, në atë kohë arsimtari, profesori me të pa në korzë, ajo ka qenë tragjedi e le mo tjetër (buzëqeshë). Jeta në atë kohë, sidomos e nxansave të fshatit ka qenë shpi-shkollë, shkollë-shpi. Pastaj humbja e kohës aty deri sa u majshin gjashtë orë, deri u kthejshim në shpi u dashke për nesër me u pregaditë a me mësim, s'e ke pasë lluksin me dalë në mramje. Pastaj u dashke me i nimu familjen, a rreth bujqësisë, e blegtorisë e... u konë ni jetë e vështirë.

Anita Susuri: Ju thatë që shkollën e mesme e keni përfundu në Pejë...

Avdi Dinaj: Po.

Anita Susuri: Po, pastaj keni vazhdu në Prishtinë...

Avdi Dinaj: Po...

Anita Susuri: Gjatë kësaj periudhe a ka lëvizë edhe familja juje?

Avdi Dinaj: Jo, familja kanë ngelë në Raushiq, kurse une... në atë kohë rruga ka qenë e mundshme veç me tren Pejë-Fushë Kosovë, se nuk ka qenë rruga magjistrale sot që osht'. Udhëtimin e kemi bo me tren, pastaj jom vendosë në konvikt të studentëve. Gjatë studimeve kom banu në konvikt.

Anita Susuri: Në cilat vite po i bjen që ju keni studiu?

Avdi Dinaj: Kom regjistru fakultetin '71 - '72. Kom diplomu me 11 shtator 1976.

Anita Susuri: Qysh ka qenë në atë kohë Prishtina?

Avdi Dinaj: Prishtina ka qenë, e di se më kujtohet, qytet i studentëve. Prishtina në atë kohë i ka pasë dikun 36 mijë studentë. Me siguru ni krevet në konvikt ka qenë premi për studentin. Nuk ka pasë konvikt sa ka sot, kanë qenë më kujtohet atëherë. Para fakultetit juridik jonë kanë ato pavilionet, nalt ka qenë konvikti numër 1, 2, 3 edhe barakat. Rruga e cila ekziston sot ka qenë në ndërtim e sipër në atë kohë. Në fillim menza ka qenë, ni menzë e vjetër para Fakultetit Juridik ku kanë qenë ato pavilionet. E ma vonë osht' hap menza e studentëve e reja.

Anita Susuri: E në qat kohë qysh ka qenë qyteti?

Avdi Dinaj: Ka qenë në ndërtim e sipër, ka qenë në ndërtim e sipër. Ato rrugë në ndërtim e sipër, ajo pjesë para fakultetit ka qenë me pavilione, a di e pa...

Anita Susuri: Pa asfalt?

Avdi Dinaj: Po, e paasfalltume, pa...

Anita Susuri: Ka pasë baltë kështu?

Avdi Dinaj: Po, pjesa e Fakultetit Juridik e Ekonomik, ajo pjesa e amfiteatrit, atëherë ka qenë e ndërtume. Kështu që, kushtet për mbajtjen e ligjeratave kanë qenë të mira. Ka pasë, për shembull Fakulteti Juridik në vitin e parë amfiteatri u plotësonte në tanësi.

Anita Susuri: Çfarë profesora keni pasë?

Avdi Dinaj: Profesorat kanë qenë gjenerata e parë e profesorëve, të cilët edhe e kanë themelu Fakultetin Juridik. Bardhyl Çaushi, pastaj fillet e së drejtës Rifat Osmani. Pastaj kanë qenë historiati i së drejtës Hilmi Ismajli. Po kanë qenë gjenerata e parë e profesorëve, i ndjeri Faruk Presheva, i cili faktikisht ka qenë edhe themelus, ndër themelusët e Fakultetit Juridik. Ai ka qenë ndër civilistët më të

mirë që ndonjëherë ka pasë Kosova. Mirëpo, ai ka ligjëru në atë kohë pothuaja në të gjitha landët, edhe civile edhe penale. Edhe të drejtën e detyrimeve, edhe të drejtën ekonomike, po ka qenë një civilist i pashoq, i cili mbahet mend.

Anita Susuri: A është bisedu atëherë, për shembull për kombësinë shqiptare, për pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi? Ju si studentë, a keni pasë kësi diskutime?

Avdi Dinaj: Po atëhere në atë kohë, në atë kohë kur ndryshimet kushtetuse... faktikisht na kemi qenë jo republikë po shtet, a? Mirëpo, kemi pasë liri maksimale si studentë. Sa i përket jetës kulturore, unë kom qenë adhurus i madh i Teatrit Popullor Krahinor në atë kohë. Aty s'ka pasë premiere, s'ka pasë dramë që nuk kom shku.

Anita Susuri: Qysh ka qenë atëherë me shku në teatër? Disa thojshin që u dashtë me u vesh ma veçantë, ma bukur me u dokë?

Avdi Dinaj: Aty në premierë, për shembull ka qenë fat i madh nëse siguron biletë. Se ato janë siguru për elitën politike të asaj kohe. Nëse mbetet diçka për studentë atëherë ke mujt me siguru.

Anita Susuri: Çfarë shfaqje ka pasë përshembull, a ju kujtohet naj shfaqje?

Avdi Dinaj: Po ka, ka qenë elita e artistëve të asaj kohe, Melihate Ajeti, Xhevat Qorraj, Istref Begolli, a, mos t'i përmeni te tonë. Po ka qenë një elitë e jashtëzakonshme. Edhe nuk ka pase premieria... shfaqje që osht' shfaqje në teatrin popullor që nuk osht' mbushë.

Anita Susuri: Pasi keni diplomu, ju keni marrë vendim me u kthy në Mitrovicë, a po? Te familja juj që ka qenë në Mitrovicë, apo?

Avdi Dinaj: Urdhno?

Anita Susuri: Familja a kanë qenë në Mitrovicë e vendosun masi keni diplomu...

Avdi Dinaj: Jo, jo, në Raushiq.

Anita Susuri: Aha, ju pastaj keni marrë vet vendim.

Avdi Dinaj: Po, me pëlqimin e prindëve. Me pëlqimin e prindëve jom vendosë në Mitrovicë.

Anita Susuri: Tregut që në Pejë ka qenë pak ma problem për shkak të vëllaut e këto...

Avdi Dinaj: Po...

Anita Susuri: Edhe qysh ka ndodhë tani qajo, qaj ndryshimi? Ju prej Raushiqit në Prishtinë, pastaj prej Prishtinës në Mitrovicë, qysh e keni përjetu qat ndryshim?

Avdi Dinaj: Po në fillim ka qenë e vështirë ndarja nga familja. Mirëpo, në ndërkohë, pas marrjës t'banesës, shoqja punonte në arsim, kem pasë ble një kerr t'asaj kohe edhe pothuaj çdo javë gjatë vikendeve shkojshim te familja ime.

Anita Susuri: Qysh ka shku puna juj gjatë qasaj periudhe?

Avdi Dinaj: Me punu si gjyqtar nuk ka qenë e lehtë, është një punë e randë, a? Punë me përgjegjësi, mirëpo e kom dashtë profesionin tim.

Anita Susuri: Çfarë raste ka pasë, për shembull ma s'shumti?

Avdi Dinaj: Në Gjykatën Komunale një periudhë kom punu në laminë civile, nja tri vite. Pastaj një vit në hetim, pastaj kom punu në penale. Dhe ka qenë viti '82 kur kom fillu në laminë penale, mo nuk e kom lëshu laminë penale deri në pensionim. Mirëpo, sipas nevojës është dashtë me punu edhe në laminë civile.

Anita Susuri: E çka osht' dallimi, se nashta dikush nuk e din? Lamia civile edhe penale.

Avdi Dinaj: Paj lamia penale...

Anita Susuri: Çfarë raste jonë për shembull?

Avdi Dinaj: Po, në laminë penale hyn plagosjet e lehta, të randa, vrasjet, vrasjet në tetnativë, a? Çdo gja çka osht' lidhur me krimin. Kurse në laminë civile çashtjet pronësore.

Anita Susuri: Domëthanë, gjatë qasaj kohe që keni punu ju, edhe jeni përcaktu për atë lami, çfarë... nëse mundeni pak ma shumë me elaboru qet pjesë?

Avdi Dinaj: Po...

Anita Susuri: Edhe qysh ka qenë punë në kolektiv me krejt komunitetet që kanë jetu n'atë kohë, qysh ka qenë?

Avdi Dinaj: Po, kqyre tash n'atë kohë kanë ekzistiu komunitetet, unë si gjyqtar i Gjykatës të Qarkut thanë t'drejtën kom pasë ndoshta edhe fatin, unë kom gjyku landë, sidomos landë t'rana t'vrasjeve e këto, por landë politike, jo. Nuk e di arsyen, noshta ka qenë arsyeja pse e kalumja e familjës, po nuk, nuk kom pasë landë politike. Krejt çka kom pasë, kom pasë dy landë, tri, politike. Ndër to e kom pasë edhe hetimet e rastit të minatorëve

Anita Susuri: Para se me mrri aty po du edhe me folë për vitin '81 kur kanë ndodhë demonstratat, qysh ka qenë qajo periudhë?

Avdi Dinaj: Po unë në vitin '81, '79, '80, kom qenë ushtar. Në '81 demonstratat patën përfshi krejt Kosovën, por nuk ka qenë e lehtë.

Anita Susuri: N'cilin vit jeni kthy prej ushtrisë?

Avdi Dinaj: Urdhno?

Anita Susuri: N'cilin vit jeni kthy prej ushtrisë?

Avdi Dinaj: 1980.

Anita Susuri: '80, po. Edhe pastaj keni vazhdu punën menjëherë?

Avdi Dinaj: Po, menjëherë.

Anita Susuri: E po m'intereson a keni pasë raste më ngjarjën që ka ndodhë, ndonjë student apo dikush?

Avdi Dinaj: Po mendon me gjyku?

Anita Susuri: Po.

Avdi Dinaj: Ja-a.

Anita Susuri: S'keni pasë ju?

Avdi Dinaj: Ja-a, s'kom pasë rast.

Anita Susuri: E vet qysh ka qenë atmosfera n'qat kohë, a ju kujtohen ditët kur kanë ndodhë demonstratat?

Avdi Dinaj: Po ka qenë një atmosferë e zyrt, një atmosferë... a? Po e shef rininë me organe policore t'u i shty, nuk osht' e lehtë, ata kanë qenë faktikisht fëmitë tonë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Deshtët me vazhdu me folë për rastin e minatorëve nëse mundeni tash me na spjegu krejt qysh ka ndodhë, qysh... fillimisht kur keni dëgju që po ndodhë kjo grevë, qysh jeni ndi e krejt?

Avdi Dinaj: Po e di, atëherë, atëherë patën fillu grevat e minatorëve...

Anita Susuri: Fillimisht marshi ka qenë...

Avdi Dinaj: Po...

Anita Susuri: Pastaj ata janë marrë në pyetje.

Avdi Dinaj: Po ka qenë marshi, shkumja në kamë në Prishtinë për çashtje politike. Edhe... ju kujtohet, kërkojshin dorëheqjen e...

Anita Susuri: Rrahman Morinës...

Avdi Dinaj: Hysamedin Azemit, e atyne personave tjerë. Mirëpo, ato çashtje unë i kom përcjellë prej televizionit n'atë kohë. Mirëpo, kur ka ardhë, kur ka fillu procedura e di si sot... ka qenë dikun, nëse nuk gaboj, 13 marsi i '89. Pas përfundimit të orarit të punës kom shku në banesë. Diku në orë të mbramjës ish kryetari i Gjykatës të Qarkut n'atë kohë Kapllan Baruti e kishte dërgu vozitësin e tij me m'marrë me kerr. Edhe po i thom vozitësit, thashë, "Çka ka t're bre?" Tha, "Vallahin, po të kërkon krytari".

Kapllani ka qenë një njeri i jashtëzakonshëm, një njeri jashtëzakonisht i mirë. Më ftoi në zyre. Tha, "T'kom thirrë me marrë rastin e Vllasit..." më tregoi që qeshtu, qeshtu, po e sjellin prej Bijeline, po dojnë më fillu procedurën. Prokurori e ka ngritë veç kërkesën për zbatimin e hetimeve. kontrarevolucion, kontrarevolucioni atëherë, dënimi maksimal i kontrarevolucionit ka qenë 20 vjet, ose dënimi me vdekje. E di, kem bisedu me Kapllanin, po m'thotë, "Tu kisha lutë me i marrë hetimet me i kry". Thashë, "Kapllan, për çmimin me u shkarku, nuk e marr. Dej sot s'kom pasë raste politike, as sot s'po du me i marrë".

Në bisedë e sipër me të, "Nëse nuk i merr ti, duhet me ja dhonë dikujt që s'munën me pasë qasje mo n'landë". Bile une e di se i kom thanë, thashë, "Jepja kujt dush e bo çka t'dush me të. Unë, jo". Për me ma ndryshu menjën e ka thirrë Tadej Rodiqin. Në bisedë me Tadej Rodiqin po më thotë, tha, "Nuk osht' e rastit pse kem bisedu me t'marrë ty si gjyqtar hetues". Edhe ai po ma tregon historinë e vet. Ndër tjera po m'thotë, "O Avdi, në rastin e Marie Shllakut, vllau jem ka qenë i burgosun me Marie Shllakun, kur u lëshu prej burgu krejt tre mujë ka jetu se e kanë shkatërru". Thotë, "Nëse na nuk e koçisim çashtjën qesaj rradhe kur don me, me, me..."

Me lutjet e tyne, me kërkesën e tyre, lutjën e tyre, kom pranu me i zbatu hetimet. Aty për paraburgim s'ke pasë çka me dhanë se n'atë kohë me ligj të procedurës penale, për vepër penale për t'cilën parashihet dënimi me vdekje, paraburgimi ka qenë i detyrueshëm. Kom fillu hetimet, jonë marrë n'pyetje herën e parë Azem Vllasi, Aziz Abrashi edhe Burhan Kavaja. Pastaj ka fillur zgjerimi i hetimeve. Kanë qenë diku 15 të pandehur.

Anita Susuri: Çfarë pyetje, për shembull ju keni bo atyne se akuza ka qenë për kontrarevolucion, po ku ka qenë baza?

Avdi Dinaj: Baza ka qenë qato demonstrata. Baza kanë qenë demonstratat, po ajo osht' ditë që osht' nji landë politike, eufori e momentit, se ata u lirunë, a?

[Këtu nderprehet intervista]

Avdi Dinaj: Në fillim hetimet kanë fillu kundër Azem Vllasit, Aziz Abrashit edhe Burhan Kavajës. Jonë marrë n'pytje në cilësinë e të pandehurit. N'atë çashtje hetimore, penale kanë qenë të angazhumë avokatët më eminent të ish Jugosllavisë. Ndër ta ka qenë i ndjeri Bajram Kelmendi, nji, nji avokat që n'trojet shqipëtare vështirë që do vjen ndonjëherë shoqi i tina. Ka qenë Rajko Danilloviqi i Beogradit, i Zagrebit, Drago Demshari i Sllovenisë, Rajko Danilloviqi i Beogradit, Vesta Peshiqi. A din qysh? Ka qenë elitë e avokatëve t'asaj kohe.

Anita Susuri: E pse kështu, a ka qenë ngjarje shumë me rëndësi kjo që...

Avdi Dinaj: Po ka qenë... faktikisht i dridhi temelet e Jugosllavisë a, qysh thojshin n'atë kohë. Edhe kom marrë n'pytje Vllasin, e di si sot... se për ekipin e prokurorisë kanë punu një grup i juristëve të angazhumë prej Beogradit, e di si sot. Ndërsa unë përkrahje përpos kolegëve, kom pasë kryetarin e gjykatës Kapllan Barutin edhe Tadej Rodiqin, edhe me t'cilët jom konsultu. Bile e di me një rast gjatë marrjës n'pytje e bam një pauzë me pi kafe. Isha tu e marrë n'pytje Vllasin, po thotë, "E kisha pi një kafe..."

Anita Susuri: Vllasi?

Avdi Dinaj: Po. Edhe unë pa nji, pa dy, ia porositi kafën. Isha i ri, nuk m'ka shku menja n'ato gjana. Rastësisht e kom taku Kapllanin në koridor, tha, "Hë, a po bon pauzë?" Thashë, "Po, po pijmë ka nji kafe". Tha, "Mos i porosite edhe Vllasit?" Thashë, "Po, pse jo?" Tha, "Prit". E ka njoftu Tadeji, veç sa me... Tha, "Edhe këto kafe..." Atëherë ka qenë si sot 20 cent kafja ne gjykatë. Tha, "Këto kafe paguhën me llogari". Thashë, "Pse bre me llogari?" "Le..." Kemi pi kafe, kur kem vazhdu e ka pa Spasoja që Vllasi ka pi kafe, ka kërku vazhdimin e pauzës, u bo kafja bauk, e morrën vesh krejt organet që ka porositë kafe n'zyre (buzëqeshë). Kjo, a, qaq u konsideru... edhe pse me ligj, edhe pse osht' i pandehur ka të drejtë n'pushim, ka të drejtat e veta t'cilat, a... Mirëpo, meqë ishte në grup politik gjoja se...

Anita Susuri: E çka ka qenë ajo që kanë folë ata, çfarë përgjigje ju kanë jep juve?

Avdi Dinaj: Po për rrjedhën e ngjarjeve të demonstratave të asaj kohe. Mos kanë qenë, se Vllasi i vizitoi minatorët në zgafellë, pastaj shkun n'ata se Vllasi, Aziz Abrashi si drejtor gjeneral i "Trepçës", Burhan Kavaja si drejtor i minierës në flotacionin Stari Tërg i kanë organizu punëtorët me hi në grevë edhe m'u mbyllë në horizonte. Mirëpo, me prova nuk është argumentu se ka pasë ndonji organizim por kanë qenë paknaqësitë e zhvillume n'rrethanat politike të asaj kohe.

Anita Susuri: E ju a e keni kuptu këtë, apo keni pasë edhe ju dyshime që ndoshta kta kanë mujtë me i organizu?

Avdi Dinaj: Roli i gjyqtarit hetues osht' me e qitë në procesverbal ato çka thojnë, a po kupton?

Anita Susuri: Po.

Avdi Dinaj: Me qenë sa ma i saktë n'dhanjën e deklaratës t'tyne.

Anita Susuri: Ju ma përmendët që n'qat kohë keni qenë nonstop i përcjellun.

Avdi Dinaj: Po, prej marrjës t'hetimeve, faktikisht në momentin që jom dalë nga banesa me shoqën e me fëminë i kom vrejtë, atëhere Sigurimi Shtetëror, persona t'cilët m'përcjellin n'çdo hap. Ka qenë e pamundur, për gjashtë mujë sa i kom pasë hetimet, mos me qenë i përcjellur. Jo vetëm unë, po edhe kolegët tjerë që kanë qenë, e sidomos kryetari i gjykatës. Pastaj në zyrën teme faktikisht s'kom guxu kurgjo me folë se dyshojshim mos jonë t'vnumë përgjuesit n'zyre.

Anita Susuri: M'thatë edhe që keni pasë kontakte edhe takimet që i keni bo në Zhlep atje?

Avdi Dinaj: Po. Po njerëzit që kanë qenë të interesum kurrëniherë kontaktet nuk i kom bo në Mitrovicë. Kom marrë shoqën, fëmijët... ata që dëshirojshin, njerëzit e politikës, njerëz t'asaj kohe që dëshirojshin me bisedu me mu direkt për çashtjën... une shkojsha, se i kom pasë, gjatë verës delshim n'bjeshkë, familja. E kontaktet i zhvillojsha atje. Ka pasë persona t'cilët u interesojshin për çashtjën edhe aty u njoftojshin për çdo detaj.

Anita Susuri: Çfarë detaje për shembull, lidhur me qysh po shkon procedura?

Avdi Dinaj: Po.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë seancat që jonë mbajtë për këta 15 persona?

Avdi Dinaj: Seanca aty s'ka pasë, jonë marrë n'pytje secili veç e veç në zyre, në prezencën e avokatëve. N'fillim kanë dhanë deklarata, pastaj jonë, me propozim të prokurorit atëherë jonë kërku me u sqaru rreth provave, t'gjithë t'pandehurit kanë heshtë, nuk kanë dhanë deklarata. Unë i kom marrë n'pytje vetëm t'pandehurit, ndërsa dëshmitarët jonë marrë nga Sigurimi Shtetëror. Ka qenë i caktum një prokuror, Rexhep Kaçaniku, i cili i ka marrë. Por, nga gjyqtari hetues nuk ka pasë asnjë vendim mbi besimin e dëgjimit të atyne dëshmitarëve. Ata i kanë marrë pa dijeninë... dijeninë, kemi pasë dijeninë po ata i kanë marrë pa vendim të gjyqtarit hetues.

Bile e di kur filloi gjykimi, tani i ndjeri Ismet Emra u kthy si kryetar i gjykatës, ka qenë kryetar i trupit gjykues. Avokatë gjatë shqyrtimit gjyqësor po kërkojnë veçimin e ktyne deklaratave të dëshmitarëve, edhe pse s'kishte diçka me randësi n'ato deklarata, veçimin e tyre se nuk jonë besu nga ana e gjyqtarit hetues. Po m'thrret, tha, "Ke qenë gjyqtari hetues, a ka ndonjë vendim që ju ka besu dëgjimi i dëshmitarëve nga ana e Sigurimit?" Thashë, "S'ka". "Pse?" Thashë, "Se s'kanë kërku as s'ka". Mirëpo, ka qenë fat i madh. Bile e di kur është publiku aktgjykimi ka qenë Nekibja, Nekibe Kelmendi në zyrën time kur janë liru prej akuze. Ka qenë nji, nji, nji kënaqësi e veçantë kur...

Anita Susuri: A ju nuk keni qenë i pranishëm në sallë?

Avdi Dinaj: Jo, unë vetëm hetimet i kom kry. Unë s'kom pasë të drejtë me qenë as anëtar i trupit gjykues e as me gjyku çashtjen.

Anita Susuri: Neve na kanë tregu shumica, sidomos Burhan Kavaja që nuk e kanë pritë që kanë m'u liru. Domethonë, ju ka ardhë si çudi.

Avdi Dinaj: Ata...

Anita Susuri: A e keni mendu edhe ju kështu? Qysh ka qenë opinionimi i juj lidhun me qito, a kanë me i dënu apo jo?

Avdi Dinaj: Unë, opinionimi i jem, unë e kom çdo detaj të qartë që s'e kom ditë. Opinionimi i jem ka qenë se prova nuk ka. Prova nuk ka se jonë ndëgjy dikund 119 dëshmitarë. Ato deklaratat tana herët, s'pari herë kanë ardhë te unë. Prova s'ka pasë. Pa prova është diçka tjetër.

Anita Susuri: Kur i keni zhvillu këto hetimet, a po ju kujtohet këta njerëz në çfarë gjendje jonë konë? A kanë qenë të friksum apo...?

Avdi Dinaj: *Uff* {onomatope} kanë qenë të shqetësuar, kanë qenë të shqetësuar. Kanë qenë... ka qenë një periudhë e zyrtë edhe për ta se...

Anita Susuri: A ju kujtohet najnjoni për shembull veçanërisht diçka që e kishit veçu?

Avdi Dinaj: M'kujtohet, m'kujtohet si sot diku ka përfundimi i hetimeve, në përfundim të hetimeve Aziz Abrashi nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore edhe m'kanë kërku me shku me vizitu te burgu. Bile e di si sot kemi shku unë edhe Spasoja, se dytë kërkunë me shku më i vizitu edhe po i bijmë prej gjykate trup për me ra në burg. Ish drejtori i burgut ka qenë njëfarë Sherafedin Ajeti. Ndër to po thonë Spasoja, tha, "A don", tha, "Avdiu nëse hyn në burg", gjoja se i dështunë hetimet. E dike edhe ai që i dështunë hetimet, "me ja caktu ndonjë dhomë të veçantë?" Unë i thashë, "Nuk e di a për mu, a për ty?" Sherafedin Ajeti, po thotë, "Nëse e fitojnë të ktijna dihet Spasojë që mu e tye, e nëse fitojmë na ja sigurojmë këtij një dhomë". Ajo ka qenë një shaka jo e mirë.

Pastaj, kemi hy kemi bisedu me Aziz Abrashin. Kom arritë me bindë që kjo është një çashtje e hetimeve, osh' një çashtje e mbledhjes së provave. "Provat janë mbledhë, do të dalësh në shqyrtim. Në bazë të provave ekzistuese do të mirret vendimi meritor. Mirëpo, nuk ke nevojë me bo tragjike". Edhe kështu që kur filloi gjykimi, pastaj ka qenë një gjykim i stërzgjatun, gjykim e plot batuta gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Anita Susuri: Çfarë batuta për shembull?

Avdi Dinaj: Çfarë batuta? Po avokatët e asaj kohe kanë qenë elita e avokatëve. Meqë s'kom qenë dëshmitar i drejtëpërdrejtë, s'kom qenë aty, tregojnë të tjerët që kanë qenë prezent, sidomos Adem Vokshi, Faruk Korenica të cilët janë gjallë. Ka edhe të tjerë, Xhafer Maliqi.

Anita Susuri: A jeni taku pastaj masi që është marrë vendimi në këta njerëz, apo si ka vazhdu?

Avdi Dinaj: Jom taku me Lazër Krasniqin pasi që u marrë aktigjykimi. Bile, e di se Lazër Krasniqi tani jeton diku në Opati po më duket. Ka qenë drejtor i KEK-ut. Kur kom fillu me i marrë në pyetje pa ardh prokurori, pa ardh avokatët, tha, "Gjyqtar, a muj me të pytë diçka?" Thashë, "Urno?" Tha, "A e din Kapllan Baruti që unë jom në burg?" Thashë, "Po". Tha, "Kurgjo tjetër s'po m'duhet".

Pasi që ka dalë prej burgu, ma vonë kur jam taku me të, ka pasë një respekt. Po më thotë, tha, "Gjyqtar po m'vjen mirë që të pashë". Thashë, "Edhe mu po më vjen mirë që..." Tha, "Gjyqtar", tha, "në momentin që ki fillu me më marrë në pyetje e kom ditë ka i ki komtë". Edhe unë si në shaka po i thom, thashë, "Eh, atëherë nuk kom qenë gjyqtar hetues i mirë, se gjyqëtarit të mirë hetues pala nuk guxon me ditë ka anon, se gjyqtari duhet me qenë i paanshëm".

Anita Susuri: A ju kujtohet qajo ditë qysh ka qenë kur jonë liru se qysh na kanë tregu ka qenë si një lloj feste?

Avdi Dinaj: Po, ka qenë festë si me qenë festë kombëtare. Kur jonë dalë prej burgut e di si sot, pastaj erdh edhe Bajrami, Bajram Kelmendi erdh në zyrën teme, se Nekibja ishte te unë, se Nekibën e kom pasë mësuese në shkollën fillore. Për dritare e kemi pa, t'u mledhën njerëzit, a din qysh me... as festa kombëtare nuk u festu ma, ma shumë.

Anita Susuri: A i keni pa ata t'u dalë?

Avdi Dinaj: Po, se burgu është nën gjykatë e u dashtë me dalë në komë knej kah dritaret e gjyqit {përshkruan me duar} edhe me dalë në rrugën kryesore.

Anita Susuri: E qysh ju kanë dokë ata? A kanë qenë të lumtur?

Avdi Dinaj: Po kqyre ata pas diku tetë mujve, gati një vit me dalë në liri nuk osht'...

Anita Susuri: Qysh kanë vazhdu pastaj vitet e '90-ta? Përkeqësohet pak situata politike edhe fillojnë edhe këto demonstratat tjera. Qysh kanë vazhdu këto vite për juve? Deri në cilën kohë keni punu ju si gjyqtar?

Avdi Dinaj: Kom punu deri në vitin, në fillim të vitit '92 kur janë shkarku të gjithë gjyqtarët në Kosovë nga ana e Kuvendit të Serbisë. Deri në atë kohë kom punu si gjyqtar, pastaj kom dalë avokat.

Anita Susuri: Si ka ndodh ai shkarkim? A e keni pritë?

Avdi Dinaj: Ajo osht' pritë mos sot, nesër. E kemi pritë prej të '90-tave veç kur po ndodh. Bile e di se atëherë kanë pasë një rol sindikatat. Sidomos Bajram Kelmendi e di se ka pasë ardh, "Duheni me nejt deri në momentin që ju shkarkojnë". Pastaj na shkarkunë, na shkarkunë të gjithë shqiptarëve, e mushën me serbë.

Anita Susuri: A kanë pru njerëz të tjerë serbë apo kanë qenë qata që keni punu?

Avdi Dinaj: Kanë qenë kuadrat e serbëve, malazezëve këtu në Mitrovicë. Dy-tre, njo ka ardh prej Çaçakut, njo dy-tre krejt të ardhun nga jashtë Mitrovica, tjerët kanë qenë mitrovicas.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj vitet e '90-ta si avokat?

Avdi Dinaj: Po si avokat në atë kohë faktikisht krejt gjyqsori ka qenë me serbë. Kemi ekzistuar. (buzëqeshë) Një pjesë, unë e kom pasë në datën e bombardimit diku nja dymbëdhjetë të pandehur, krejt pa pare, të cilët jonë lëshu pas futjes të trupave të NATO-s në Kosovë. U dashtë m'u kujdesë. I kemi pasë nda ne që punojshim në laminë penale diku disa, diku disa.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qato, domethonë fillimi i përkeqsimi të situatës dhe fillimi i luftës? Qysh ka qenë qajo kohë?

Avdi Dinaj: Po ka qenë një periudhë e zyrtë. Ka qenë një periudhë jashtëzakonisht e zyrtë. Për shembull, si e ki kry orarin e punës u dashtë me shku me hi m'u mbyllë në banesë. Nejse ju jeni të ri por u konë shfaq dora e zezë, persona të caktum veç i merrshin i likfidojshin e i lejshin nëpër rrugë. Si osht' errësu mo mbyllu në banesë e deri të nesrit...

Anita Susuri: A e keni ndje veten të rrezikim?

Avdi Dinaj: Po, mesiguri. Jo vetëm unë, por te tonë kolegët e kanë ndi veten të rrezikun. E di si sot e kemi pasë një gjykim me Shyqri Sylën, një landë politike edhe i patëm shti m'u mbrojt në heshtje, mos me dhonë deklarata edhe si e kemi përfunduar seancën po i thom Shyqës, "Mos shko në zyre se nuk o situatë e mirë". Unë menisherë prej Gjykatës në banesë, se kom qenë banesën në pjesën veriore. E di si sot, atij si ka shku me hi në zyre me e lonë çantën i kanë kcy policia e te kanë bo... {përshkruan me duar} bile ka qenë rast i lajmrum atëherë për dhunën e ushtrime ndaj ti.

Anita Susuri: Gjatë luftës a keni qenë këtu?

Avdi Dinaj: Gjatë luftës nuk kam qenë këtu. E ka pasë baxhanaku im një vikendicë afër Ribariqit, kemi shku me nejt dy-tri ditë para bombardimeve në vikend. Kur fillunë bombardimet mo s'ki mujt as me hi as me dalë prej atyne vikendicave. Pastaj, qashtu qysh kom qenë e kom marrë fëminë kom dalë dikun ka 8 prilli [1999]. Menxi kemi dalë në Mal të Zi. Kom qenë i vendosun në Ulqin deri me futjen e trupave të NATO-s në Kosovë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qaj udhëtimi me shku deri në Mal të Zi?

Avdi Dinaj: Po, ka qenë shumë i vështirë për faktin se ne ku kemi qenë të vendosun afër Ribariqit, nja dy kilometra janë ato vikendicat, mo s’kemi mujt as me hy as me dalë. Deri me 8 prill kemi nejt se s’kishim mundësi as hyrje as dalje. Tojshi e kemi pasë një kojshi, jemi nisë me kerr për Novi Pazar. Ekziston një rrugë aksesore. Jemi shku në Tutin, prej Tutinit osht’ një rrugë aksesore që del në Rozhajë, jo të magjistrales, por një rrugë e kundërt ku atje s’ka pasë forca policore edhe kemi dalë në Rozhajë. Prej Rozhajës, kur kemi hy në Rozhajë ka qenë diçka tjetër e pastaj kom vazhdu për Ulqin, e aty kom qenë i vendosur deri në kthim.

Anita Susuri: Qysh e keni pranë lajmin që u çliru Kosova, që u kry lufta?

Avdi Dinaj: Ka qenë, po vjen liria. A ka gja ma të shtrejtë?

Anita Susuri: Qysh keni marrë tani vendim m’u kthy? Qysh e keni gjetë banesën?

Avdi Dinaj: Jom kthy në kolonën e parë që është prej Ulqinit, ka qenë me 23 qershor të ‘99-tës. Meqë situata politike edhe Mal të Zi ke e shqetësime. Organet policore të Malit të Zi, u bo kolona njo, mos me thonë njo tre kilometra të shqiptarëve të Kosovës që kemi qenë në Ulqin. Nuk na ka lonë me shku kërkush vetmas. Kanë dalë policia mrapa, kolona e kerreve tek deri që kemi hy te Kulla në Zhlep na kanë përcjellë policia e Malit të Zi.

Anita Susuri: Pastaj kur keni ardhë këtu?

Avdi Dinaj: Pastaj kur kemi ardhë këtu...

Anita Susuri: Ma s’pari qysh ju ka dokë Kosova t’u ardhë deri në Mitrovicë?

Avdi Dinaj: Po, ka qenë çdo gja e shkatërrime, çdo objekt i shkatrrum. Unë e kom pasë banesën në pjesën veriore. Kur kom, kishin qenë forcat franqeze. Banesë tjetër s’kom pasë. Pastaj u dashtë m’u vendosë te miqtë një periudhë deri e bona nji zgjidhje për banesë, kështu.

Anita Susuri: Domethonë, s’kemi mujt me u kthy kurrë në banesë?

Avdi Dinaj: Ma vonë kemi mujt veç në komë me pa banesën, por çka ki pasë me pa banesën. Banesa dera e thyme, gjanat e vjedhuna, librat. E kom pasë një literaturë profesionale të jashtëzakonshme. Krejt të marrura, me mobilje, e demolume. Pastaj janë vendosë serbët në pjesën veriore me banesë dhe mo s’kom mujt me shfrytëzu.

Anita Susuri: Tash e keni zgjidhë apo?

Avdi Dinaj: Po e kom zgjidhë problemin.

Anita Susuri: Thatë që prej vitit 2000 keni fillu me punu prapë si gjykatës. Qysh ka ndodhë kjo? Qysh keni marrë vendim apo ju kanë thirrë?

Avdi Dinaj: Atëherë, në fillim, në shtator u formun ato gjykatat emergjente te cilat punojshin vetëm në laminë penale edhe pastaj unë e kom paraqitë kërkesën në fillim të vitit 2000 jom zgjedhë si gjyqëtar i Gjykatës së Qarkut. Kom punu deri në vitin 2002. Pastaj kom apliku për me u zgjedh si gjyqtar i Gjykatës Supreme. Në nëntor të vitit 2002 jom zgjedh si gjyqtar i Gjykatës Supreme. Ja kom nisë punën me 11 janar 2003, deri në pensionim në 2017 kom punu si gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Anita Susuri: Qysh po vazhdon tash jeta? Jeni me pension apo tash?

Avdi Dinaj: Po, tash jom në pension. Kom hapë një zyre të avokaturës me djalin edhe me renë, të tretë jemi avokatë. Po ekzistojmë. (buzëqeshë)

Anita Susuri: Nëse kishit dashtë edhe diçka me shtu ose me tregu ose na s'kemi pytë nëse ju doni me sqaru?

Avdi Dinaj: Po s'kisha çka me shtu ma shumë.

[këtu ndërprehet intervista]

Korab Krasniqi: Zotri Avdi po të kthej veç pak mbrapa tek '89-ta prapë. Domethonë, në '88-tën është bo marshi i minatorëve prej Stantërgut në Prishtinë.

Avdi Dinaj: Po.

Korab Krasniqi: Mandej me 20 shkurt ka fillu greva e minatorëve.

Avdi Dinaj: Po

Korab Krasniqi: Pastaj diku ka tetori-nëntori i '89-tës, tetori-nëntori, tetori, 7 tetor m'doket ka qenë, është bo m'doket edhe një grevë e dytë mrena në zgafellë. Kanë qenë një grup ma i vogël i minatorëve që u patën nguju për një periudhë ma të shkurtë, katër ditë m'doket kanë pasë qëndru. Mirëpo, kjo ka qenë ma e shtrëngume, pak ma e dhunshme edhe pjesëmarrësit në këtë grevë kur jonë sjellë pastaj, kur jonë marrë në pyetje, për shembull rasti i zotri Gjeloshit. Ai tregon që ka qenë mjaft e dhunshme, mjaft e vështirë. A të kujtohet ty diçka prej rastit?

Avdi Dinaj: Jo, une nuk e kom pasë atë rast.

Korab Krasniqi: A e keni ndëgju prej kolegëve për rastin?

Avdi Dinaj: Kqyre, kom ndëgju prej kolegëve, mirëpo nuk kisha pasë qef me interpretu fjalë të kolegeve.

Anita Susuri: Po.

Avdi Dinaj: Nuk osht' adekuate, nuk osht' origjinale.

Anita Susuri: Në rregull. Faleminderit për intervistën edhe për tregimin e juj.

Avdi Dinaj: Ishalla ka dalë mirë. (buzëqeshë)